

## KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot me datë 12.05.2023, palët nënshkruese si më poshtë bien dakort për të lidhur këtë kontratë për shitblerje kuotash të kapitalit të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k.

Shitësi:

**Z. Sefer Selim ERDEM**, i biri Muhammed Ridvad, lindur më 21.05.1961, banues në Rr. "Shahin Krasniqi. Nr. 23", Vushtrri, Kosovë, shtetas turk, identifikuar me kartën e identitetit nr. A18147585 me nr.personal 10123302394, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Blerësi:

**Z. Hekuran BRAHIMAJ**, i biri i Rystem, lindur në Katundisht, Përmet, më 13.08.1972 dhe banues në Rr. "Kodra e Bukur 15", Vorë, shtetas shqiptar, identifikuar me kartën e identitetit nr.031162491, me Nr. Personal H20813103N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

### **Neni 1**

- 1.1 Shitësi **Sefer Selim ERDEM** është ortak i shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS M11906023S. Nga kuotat e kapitalit të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. shitësi zotëron 1 kuotë në vlerën 33% të kapitalit të nënshkruar. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 300.000 Lekë.
- 1.2 Shitësi në bazë të vendimit datë 12.05.2023 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k., i shit tërësisht kuotën e zotëruar prej tij në nivelin 33% të kapitalit të nënshkruar të shoqëriës Blerësit, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

### **Neni 2**

- 2.1 Çmimi i shitjes së 1 kuote që përfaqëson 33% të kapitalit të shoqërisë shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. është 50.000 Lekë.
- 2.2 Çmimi prej 50.000 Lekësh konsiderohet i likujdua cash plotësisht me nënshkrimin e kontratës nga të dyja palët.

### **Neni 3**

- 3.1 Me shitjen e kësaj kuote, sipas kësaj kontrate, shitësi humbet pronësinë mbi këtë kuotë dhe blerësi bëhet pronar i këtyre kuotave me të drejta të plota.



#### Neni 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon blerësit e cila është e lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë, nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi deri në datën e sotme që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

#### Neni 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Dokumentet bashkëlidhur kësaj kontrate do të jenë Vendimi i datës 12.05.2023 i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. dhe është pjesë integrale e kësaj kontrate.

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë e nënshkruajnë.

#### PALËT KONTRAKTORE

Shitësi

**Sefer Selim ERDEM**



Blerësi

**Hekuran BRAHIMAJ**

